

FJALA E DEPUTETIT ERUARD NDRECA

E ENJTE 22 SHTATOR 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Fort të nderuar qytetarë.

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Organizatën Ndërkombëtare për Ndhim Detare në Lundrim” vjen sot për votim, pasi i ka kaluar të gjitha hallkat e tjera dhe është tërësisht në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, qoftë për sa i përket propozimit nga Këshilli i Ministrave, qoftë në përmbajtje, dhe bazohet në kreun e dytë të Kushtetutës, konkretisht në “Marrëveshjet ndërkombëtare”. Projektligji është i një rëndësie të veçantë dhe do të përpiqem të rendis arsyet pse duhet të miratohet ky projektligj, duke filluar nga qëllimi primar i tij, nga detyrimi që ka vendi ynë deri te përfitimet që kemi në momentin që bëhemi palë e barabartë në këtë marrëveshje.

Së pari, qëllimi i këtij projektligji është të krijojë kushtet dhe termat e bashkëveprimit dhe kooperimit ndërmjet qeverive dhe organizatave të interesuara për rregullimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e ndihmave detare në lundrim. Kjo do të harmonizojë sistemin e lëvizjes dhe ndihmës në lundrimin detar, si dhe do të rrisë standardet dhe sigurinë lundruese të secilit vend anëtar. Së dyti, angazhimi i vendit tonë në këtë projekt të madh të rritjes së sigurisë detare, përveçse është një nevojë kombëtare, është edhe një detyrim që ne kemi si vend anëtar i NATO-s, si pjesë e OKB-së, është kusht për t’u bërë pjesë e kësaj organizatë dhe lidhet me aspiratën tonë për t’iu bashkuar familjes europiane. Së treti, patjetër që përfitimet e vendit tonë do të jenë të mëdha dhe, duke qenë pjesë e kësaj organizatë, ne kemi mundësi të marrim nga përvoja e vendeve më të zhvilluara në këtë drejtim.

Ne do t’i ofrojmë vetes, edhe atyre që mësyjnë bregdetin, siguri shumë më të madhe, si në vendet e tjera. Ne jemi një vend më një bregdet të jashtëzakonshëm, me pasuri të mëdha që

natyra na i ka dhënë. Turizmi sot në vendin tonë ka marrë një hov të madh dhe këtë e dëshmon numri i madh i turistëve që kalojnë pushimet te ne dhe shtrirja e madhe gjeografike prej nga vijnë turistët në vendin tonë. Patjetër që rregullimi i trafikut detar nëpërmjet sinjalistikës, ndihmës dhe sigurisë do ta shtojë edhe më shumë numrin e atyre që do të vijnë në vendin tonë dhe, rrjedhimisht, do të përkthehet në zhvillim ekonomik. Siguria lundruese lidhet edhe me lundrimin e llojeve të tjera të mjeteve, jo vetëm në turizëm, dhe këtu dua të ndalem konkretisht te mjetet ushtarake, lundrimi i të cilave sot në situatën që po kalon bota, është shumë i nevojshëm të jetë më i sigurt, më i kontrolluar dhe nën vëzhgimin e detajuar të të gjithë anëtarëve të kësaj organizate.

Edhe çështjet mjedisore i konsideroj një problem të madh. Shpesh jemi përballur më abuzim ekstrem mjedisor, sepse ka munguar vëmendja e kontrolli ndërkombëtar i detajuar. Nuk kemi pse ta mohojmë që vendet më të rrezikuara janë vendet e vogla dhe aderimi në këtë organizatë do të sjellë përfitime në këtë drejtim. Aderimi i vendit tonë në këtë konventë ka disa avantazhe të tjera dhe plotëson disa objektiva të rëndësishëm, si: lëvizje e sigurt nëpërmjet përmirësimit dhe harmonizimit të ndihmave detare; ndihmë për arritjen e standardeve të sigurisë në lundrim, duke e futur Shqipërinë në hartën e vendeve të sigurta dhe më standarde në Europë; teknologji të re në këtë drejtim; rritje të nivelit të inspektimit; shkëmbim përvojash dhe njohurish; shkëmbim informacionesh të ndryshme e të tjerë.

Organizata Ndërkombëtare për Ndhimat Detare në Lundrim është themeluar sipas legjislacionit ndërkombëtar si organizatë ndërqeveritare. Kjo organizatë do të ketë natyrë konsultative e teknike dhe do të jete me seli në Francë. Kjo organizatë do të veprojë nëpërmjet organeve kryesore të saj, siç janë: Asambleja e Përgjithshme, organi kryesor vendimmarrës, i cili përbehet vetëm nga shtetet anëtare; Këshilli, me kompetenca ekzekutive të tij; komitetet dhe organet ndihmese të nevojshme për ta mbështetur dhe sekretariati. Shtetet që duan të aderojnë në këtë konventë, mund të zgjedhin statusin e një shteti anëtar, i cili ka dhënë miratimin për ta zbatuar këtë konventë, variant që do t'i bashkohemi edhe ne si shtet; shtet i asociuar dhe shtet filial. Anëtarësimi ynë në këtë konventë nuk kërkon ndryshime ligjore, pasi ka një përputhshmëri dhe harmonizim me legjislacionin shqiptar.

Nga momenti që ne bëhemi anëtarë, kemi një detyrim vjetor për të paguar, e tha edhe ministri në fjalën e tij, detyrim që vit pas viti shtohet në një kuotë të vogël dhe do të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, i cili është edhe institucioni kryesor përgjegjës që ngarkohet për zbatimin e këtij ligji dhe më pas të konventës. Institucioni që do të merret në mënyrë direkte me zbatimin e kësaj konvente për sa i përket sigurisë lundruese do të jetë Komanda e Forcës Detare, e cila nëpërmjet shërbimit hidrografik mirëmban sinjalistikën detare, prodhon hartat detare e të tjera.

Duke parë gjithçka thashë më sipër, qoftë përputhshmërinë në aspektin ligjor dhe procedural, por duke parë edhe interesin që vendi ynë ka të jetë pjesë e kësaj konvente, i ftoj të gjithë kolegët, ashtu siç kemi bërë edhe në komisione, ta votojmë! Faleminderit!